



KUVENDI I
KOSOVËS
Shtator, 2007

KOMISIONI PËR EKONOMI, TREGTI, INDUSTRI, ENERGETIKË, TRANSPORT DHE TELEKOMUNIKACION

PLANI I PUNËS 2007

Në muajin janar, Komisioni ka miratuar planin vjetor të punës, me të cilën ka paraparë dinamikën e punëve për vitin 2007. Në agjendën e Komisionit për këtë vit janë shqyrtimi dhe amendamenti i projektligjeve që bien në fushë të këtij komisioni, monitorimi i implementimit të ligjeve, vizitat në institucionet e ndryshme, mbajtja e dëgjimeve publike dhe raportimin e ministrave dhe zyrtarëve qeveritarë rreth punës së tyre. Plani i punës ka rritur nevojën e bashkëpunimit në mes të zyrës mbështetëse të komisionit dhe zyrave ligjore të Qeverisë, ngase plani vjetor i punës i Komisionit është i bazuar në masë të madhe në strategjinë legjislative të qeverisë. Prandaj, Komisioni kërkon nga Qeveria që t'i përmbahet afateve për procedimin e projektligjeve në Kuvend ashtu siç parashihen me strategjinë e saj legjislative.

TAKIMET E KOMISIONIT

Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës parashihet që komisionet parlamentare duhet të takohen së paku dy herë në muaj. Që nga muaji janar i këtij viti Komisioni ka mbajtur 23 takime të rregullta. Takimet e komisionit kanë shërbyer për shqyrtimin e projektligjeve që janë në procedurë, për tu informuar nga zyrtarët qeveritarë në lidhje me çështje të ndryshme si dhe takime të tjera me mysafirë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtare. Takimet e Komisionit kanë qenë të hapura për publikun dhe janë përcjellur nga përfaqësues të mediave dhe monitorues të organizatave të ndryshme.

FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT



Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energetikë, Transport dhe Telekomunikacion është komision funksional i Kuvendit të Kosovës. Komisioni përbehet nga 14 anëtarë të cilët përfaqësojnë partitë e ndryshme të Kuvendit. Komisioni angazhohet për përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave për zhvillimin dhe funksionimin efikas të fushave të cilat

mbulojnë ligjet të cilat shqyrtohet nga Komisioni.

Si detyrë parësore të punës së tij, Komisioni ka ndërtimin e infrastrukturës ligjore, shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve në fushat e lartpërmendura, mbikëqyrjen dhe implementimin e tyre, përcjelljen e punës së ministrive përkatëse në zbatimin e politikave të

përgjithshme si dhe mbikëqyrjen e realizimit të detyrave dhe obligimeve të gjithë atyre zyrave, bordeve dhe agjencive tjera buxhetore që bien në fushëveprimin e këtij Komisioni Parlamentar.

Komisioni gjithashtu mbikëqyrë strategjitë për zhvillimin e këtyre veprimtarive ekonomike dhe krijimin e një ambienti më të sigurtë për investime.

Kompetencat ekzekutive nga fushat që i mbulon Komisioni i takojnë: Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit. Ky Komision konsiderohet ndër më të ngarkuarit duke marrë parasysh numrin e madh të projektligjeve në procedurë si dhe mbikëqyrjen e tri ministrive të ndryshme.

SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJEVE

Projektligjet të cilat arrijnë në Kuvendin e Kosovës e të cilat janë të fushës së ekonomisë, tregtisë, industrisë, energetikës, transportit dhe telekomunikacionit, shqyrtohen dhe amendamentohen nga ana e këtij Komisioni. Gjatë vitit 2007, Komisioni ka shqyrtuar shtatë projektligje. Projektligjin për adoptimin e Konventës së

Këshillit të Evropës mbi krimin në fushën e kibernetikës nga aspekti i bazës juridike në Kornizën Kushtetuese; Projektligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor; Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për energji dhe ligjit për zyrën e rregullatorit për energji; Projektligjin për shoqëritë tregtare; projektligjin

për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për rrugët. Me qëllim të përmirësimit të kualitetit të ligjeve Komisioni ka organizuar disa takime konsultative me zyrtarë të Ministrive përkatëse, përfaqësues të shoqërisë civile dhe ka angazhuar ekspertë vendor dhe rajonal për të ofruar ekspertizën e tyre në projektligjet të cilat janë në shqyrtim.

KONTAKT INFORMATAT:

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, zyra E -211
Tel: 038 211 297 dhe 038 211 185
E-mail: hasan.tahiri@assembly-kosova.org & advie.morina@assembly-kosova.org

Me qëllim të shqyrtimit të projektligjeve me efikasitet më të lartë dhe për të përmirësuar kualitetin e ligjeve, Komisionet organizojnë dëgjime publike. Këto dëgjime shërbejnë për të siguruar opinionet dhe sugjerimet e ekspertëve të fushave përkatëse, përfaqësuesve të grupeve të interesit, organizatave joqeveritare, shoqatave të ndryshme e sidomos të përfaqësuesve atyre kategorive të cilat preken më së shumti nga projektligji i cili është në shqyrtim.

Kjo i mundëson komisionit që të ketë një pasqyrë më të qartë për çështjet të cilat i rregullon projektligji dhe u ndihmon deputetëve në marrjen e vendimeve të duhura. Përveç kësaj komisionet mund të organizojnë edhe dëgjime informative në rastet kur ka vërejtje në zbatimin e ligjeve apo kërkesave për ndryshime eventuale në ligjet në fuqi me ç'rast ftohen zyrtarë të ministrive për të informuar anëtarët e

DËGJIMET PUBLIKE



komisionit. Gjatë këtij viti Komisioni ka mbajtur katër dëgjime publike; më 10.04.2007 dëgjimin publik rreth privatizimit të pronës, kompanive për hulumtime të minierave si dhe të dhënies me koncesion të ndërmarrjeve publike; si dhe dëgjimi publik për Projektligjin për Shoqëritë Tregtare i mbajtur më 28.05.2007. Komisioni gjithashtu ka organizuar dëgjim publik në lidhje me planet për

ndërtimin e termocentralit Kosova C. Në dëgjimin publik të mbajtur së fundi, Komisioni është informuar në lidhje me situatën aktuale dhe projektet zhvillimore të Ministrisë së Transportit dhe Post Telekomunikacionit.

Në këto dëgjime janë ftuar përfaqësues të organizatave të ndryshme qeveritare, organizatave joqeveritare dhe ekspertë të cilët kanë shprehur shqetësimet e tyre

rreth projektligjit dhe kanë ofruar amendamente të dobishme me shkrim të cilat janë shqyrtuar nga Komisioni dhe disa prej tyre janë përfshirë në raportin përfundimtar të komisionit. Në përpjekje për të lehtësuar organizimin e dëgjimeve publike, së fundi personeli i Komisionit ka përgatitur një bazë të të dhënave me kontakt informatat e organizatave dhe ekspertëve relevantë të cilët mund të ftohen të japin kontributin e tyre gjatë dëgjimeve publike.

Amendamentet e propozuara nga pjesëmarrësit kanë ndihmuar gjatë shqyrtimit të mëtejme të projektligjeve, me të cilat edhe është rritur kualiteti i ligjeve dhe zbatueshmëria e tyre në terren ka qenë më e lehtë.

Komisioni edhe më tutje planifikon do të mbajë dëgjime publike, veçanërisht për ato ligje në të cilat mendohet se ka nevojë për konsultim me publikun, institucionet që do të preken nga ligji dhe ekspertë të pavarur.

VIZITAT NË TERREN

Përveç shqyrtimit të projektligjeve komisionet ushtrjnë edhe funksionin e mbikëqyrjes së punëve të institucioneve ekzekutive dhe adresimin e problemeve me të cilat përballen ato. Komisioni ka ndërmarrë një sërë vizitash në terren për të njohur më mirë me nivelin e zbatimit të ligjeve, mangësitë e ligjeve në zbatim si dhe problemet me infrastrukturën ligjore në tërësi. Gjatë këtij viti Komisioni ka organizuar pesë vizita në terren, në mesin e të cilave vlen të theksohet vizita në Aeroportin Ndërkombëtarë të Prishtinës, në Korporatën Energjetike të Kosovës dhe vizita bërë në PTK. Në këto vizita anëtarët e komisionit për së afërmi u njoftuan me problemet dhe shqetësimet e tyre të cilat kanë premtuar se do t'i përcjellin në Kuvendin e Kosovës dhe Ministrinë përkatëse.

MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË LIGJEVE

Çdo komision brenda fushës së tij të përgjegjësisë ka autoritet për të mbikëqyrur zbatimin e ligjeve nga Qeveria e Kosovës respektivisht nga ministrinë përkatëse. Synim i mbikëqyrjes është verifikimi i zbatueshmërisë së ligjeve, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme në fushën që mbulon ligji. Komisioni ka qenë mjaft aktiv në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Në këtë drejtim janë shqyrtuar dhe në vazhdimësi përcillet implementimi i ligjeve

për të cilat gjatë shqyrtimit në Kuvend, Komisioni ka qenë Komision funksional.

Komisioni këtë vit ka bërë mbikëqyrjen e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, me ç'rast pas vizitave që ka zhvilluar në terren dhe takimeve informative që ka pasur me zyrtarët qeveritarë ka dalë me rekomandime të qarta të cilat janë aprovuar nga Kuvendi si pjesë e raportit final. Momentalisht Komisioni është duke punuar në mbikëqyrjen e

ligjit për Transportin e Mallrave të Rrezikshme. Komisioni ka formuar grupin punues dhe ka caktuar institucionet që do të vizitohen dhe zyrtarët të cilët do të ftohen në dëgjime informative me qëllim të identifikimit të mangësive dhe pengesave në zbatimin e ligjit. Në këtë drejtim Komisioni do të vlerësojë gjendjen faktike lidhur me zbatimin e ligjit dhe do të përpilojë raportin që përfshin rekomandime për masat që duhet të ndërmerren nga organet ekzekutive.

AKTIVITETET E KOMISIONIT NË TË ARDHMEN

Duke u bazuar në planin e punës, Komisioni në të ardhmen do të përqendrohet në shqyrtimin e projektligjeve që vijnë në fushat që mbulon, organizimin e vizitave në terren për të parë nivelin e zbatimit të ligjeve të aprovuara dhe do të vazhdojë aktivitetet në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në fuqi. Në rast të arritjes eventuale të marrëveshjes për statusin e Kosovës, kujdes të veçantë Komisioni do të kushtoj shqyrtimit të projektligjeve që janë paraparë të miratohen me Pakon e Ahtisarit.